

JILL SANTOPOLO
DRITA QË HUMBËM

ROMAN

BOTIMET TOENA

JILL SANTOPOLO

DRITA QË HUMBËM

roman

Përktheu nga origjinali anglisht
Enkeleida Haxhinasto

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2019

Autori: Jill Santopolo (Xhill Santopolo)

Titulli në origjinal: The light we lost

Botoi në anglisht: G. P. Putnam's Sons, një degë e Penguin Publishing Group, një seksion i Penguin Random House LLC

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-54-1

© Jill Santopolo, 2017

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Për qytetin e Nju-Jorkut

Prolog

Kemi thujse gjysmën e jetëve tona që e njohim njëri-tjetrin.

Të kam parë duke buzëqeshur me besim në vetvete, të lumtur.

Të kam parë të dërrmuar, të plagosur, të përhumbur.

Por nuk të kam parë kurrë kështu.

Më mësove ta kërkoja të bukurën. Në errësi, në shkatërrim, ti gjithnjë gjeje dritë.

Nuk e di çfarë gjeje të bukur do të gjej këtu, çfarë drite. Por do të përpiqem. Do ta bëj për ty. Sepse e di që edhe ti do ta bëje për mua.

Kishte kaq shumë gjëra të bukura në jetën tonë të përbashkët.

Ndoshta këtu duhet të filloj...

1

Nganjëherë, objektet duken si dëshmitare të historisë. Kisha imagjinuar shpesh, që tavolina e drunjtë rreth së cilës uleshim gjatë seminarit të Kramerit për Shekspirin, në vitin e fundit, ishte po aq e vjetër sa vetë *Universiteti i Kolombias*; që ajo kishte qenë në atë dhomë prej vitit 1754 dhe cepat i ishin ngrënë nga breza të tërë studentësh si ne. Kjo, në fakt, nuk mund të ishte e vërtetë. Por kështu e përfytyroja unë... me studentë të ulur atje, gjatë Luftës Revolucionare Amerikane, Luftës Civile, të dyja Luftërave Botërore, Luftës së Koresë, Vietnamit, Gjirit Persik.

Është vërtet për t'u çuditur që, nëse do të më pyesje se kush ishte tjetër me ne atë ditë, nuk do të mundesha të të përgjigjesha. E kisha zakon t'i shikoja qartë të

gjitha fytyrat e tyre, por tani, pas trembëdhjetë vjetësh, më kujtohesh vetëm ti dhe profesor Kramereri. Madje nuk mbaj mend as emrin e asistentes së profesorit, e cila erdhi me vonesë në klasë, duke vrapuar. Më vonë edhe se ti.

Kramereri sapo kishte bërë apelin, kur hape derën. Teksa më buzëqeshe, pashë të të shfaqeshin gropëzat në faqe. Hoqe kapelën *Daimëndbek* dhe e fute në xhepin e prapmë. Sytë e tu u ndalën për një çast në ndenjësen e lirë, ngjitur me mua, dhe pastaj u ule.

- Ju jeni?... - pyeti Kramereri, kur po nxirrje nga çanta një bllok shënimesh dhe një stilolaps.

- Geib, - u përgjigje. - Geibrial Samson.

Kramereri kontrolloi letrën që kishte përpara.

- Të përpiqemi të vijmë në kohë gjatë pjesës tjetër të semestrit, z. Samson, - vërejti. - Mësimi fillon në nëntë. Por duhet të përpiqemi të vijmë pak më herët.

Pohove me kokë, ndërsa Kramereri nisi të fliste për temat e “Jul Cezarit”. Ai lexoi:

*- Ne, në majë, nisim 'e zbresim,
në punët njerëzore ka një valë:
e kape, kur u ngrit, je i fituar;
e le, dhe udhëtim 'i tërë i jetës
fundoset në cektësi e në mjerime.*

¹ Përkthimi origjinal i Fan Nolit. Plevasim - lundrojmë (shën. përkth.).

*Mbi det të kolmë po plevasim¹ sot;
a vemi sipas rrjedhës kur na ndih,
a mbytemi me gjith' anijen bashkë.*

- Shpresoj që ta keni lexuar të gjithë. Kush do të më thotë: si shprehet Bruti për fatin dhe vullnetin e lirë?

Do ta kujtoj gjithnjë atë fragment, sepse që nga ajo ditë e kam pyetur veten shumë herë, nëse ka qenë e shkruar që ti dhe unë të takoheshim në seminarin e Kramerit për Shekspirin. Nëse ka qenë fati, apo vendimet tona, që na kanë mbajtur të lidhur gjatë gjithë këtyre viteve...

Pasi foli Kramerit, disa studentë nisën të shfletonin shpejt e shpejt tekstin përpara tyre. Kalove gishtat nëpër kaçurrelat e tu, që kërcyen përsëri në vendin e tyre.

- Mendoj, - fillove të flisje dhe të gjithë ne kthym vështrimin nga ti.

Por nuk e përfundove dot fjalinë.

Asistentja e profesorit, emri i së cilës nuk më kujtohet, hyri rrëmbimthi në klasë.

- Më falni për vonesën, - tha ajo. - Një avion goditi njërën prej kullave binjake. Po jepej në televizor pikërisht në momentin që do të nisesha për këtu.

Askush nuk e dinte peshën e fjalëve të saj; madje as ajo vetë.

- I dehur ishte piloti? - pyeti Kramerit.

- Nuk e di, - u përgjigj asistentja duke zënë vend në tavolinë. - Prita pak, por spikerët e lajmeve nuk e kishin idenë çfarë po ndodhte. Thanë që ishte një lloj avioni me turbohelikë.

Nëse do të kishte ndodhur tani, lajmet do të kishin shpërthyer në të gjithë celularët tanë. Do të kumbonte *Twitter-i*, *Facebook-u*, si dhe do të vinin njoftime nga “New York Times”. Por, atëherë komunikimi nuk ishte i menjëhershëm dhe seminari i Shekspirit nuk mund të ndërpritej. Nuk i dhamë shumë rëndësi dhe Kramer i vazhdoi të fliste për Cezarin. Teksa mbaja shënime, vështrova gishtat e dorës sate të djathtë, që fërkonin në mënyrë të pavetëdijshme syprinën e drunjtë të tavolinës. Shkarravita në bllok gishtin tënd të madh të dorës, me thoin e ngrënë dhe lëkurëzën e shqyer në bazën e tij. E kam ende diku atë bllokun, në një kuti të mbushur me studimet klasike letrare dhe civilizimet bashkëkohore. Jam e sigurt që ndodhet aty...

2

Nuk do t'i harroj kurrë fjalët që thamë, kur u larguam nga salla e Filozofisë; edhe pse ato nuk ishin aspak të jashtëzakonshme, biseda më është ngulitur në kujtesë, si pjesë e asaj dite të tmerrshme. Nisëm t'i zbrisnim shkallët së bashku. Jo tamam së bashku... njëri pas tjetrit. Ajri ishte njëlloj i pastër, qielli njëlloj blu..., por çdo gjë tjetër kishte ndryshuar... Thjesht, ne nuk e kishim marrë vesh akoma.

Të gjithë përreth nesh flisnin me njëri-tjetrin:

- Kullat binjake u shembën.
- Mësimi është ndërprerë.
- Dua të dhuroj gjak. Dini gjë, ku mund të dhuroj gjak?

U ktheva nga ti.

- Çfarë po ndodh?

- Unë banoj në godinat lindore, - më the, duke më treguar me gisht konviktin. - Shkojmë të marrim vesh, ç'bëhet! Ti je Lusi, apo jo? Ku banon?

- *Hogan*, - u përgjigja. - Po, Lusi quhem.

- Gëzohem që u njohëm, Lusi! Unë jam Geibrial.

Më zgjate dorën. Pavarësisht gjithçkaje, shtrëngova dorën tënde dhe ngrita sytë për të të vështruar. Gropëzat në faqe t'u shfaqën sërish. Sytë blu të shkëlqenin. Në atë çast, mendova për herë të parë: "Sa i bukur qenka!".

Vajtëm te suita jote dhe pamë televizor me shokët e tu të dhomës: Adamin, Skotin dhe Xhastinin. Në ekran, trupat nxirreshin nga ndërtesat dhe grumbujt e zinj të rrënojave lëshonin shtëllunga tymi. Shkatërrimi na kishte shtangur. Ia kishim ngulur sytë imazheve në ekran dhe nuk arrinim ta besonim dot, që ato ishin të vërteta. Fakti që kjo po ndodhte në qytetin tonë, vetëm dhjetë kilometra nga vendi ku ishim ulur, fakti që ata ishin njerëz, qenie njerëzore si të gjithë ne, ende dukej i pabesueshëm. Të paktën për mua.

Celularët nuk na punonin. Përdore telefonin e konviktit, more mamanë tënde dhe i the që ishe mirë. Edhe unë i telefonova prindërve të mi në Konektikat. Më kërkuan të kthehesha në shtëpi. Vajza e një të njohuri të tyre punonte në Qendren Tregtare Botërore dhe askush nuk dinte asgjë për të. Ndërsa kushërira

e dikujt tjetër kishte pasur një mëngjes pune te *Windows*, në njërën prej kullave.

- Je më e sigurt jashtë *Manhatanit*, - vërejtji babi.
- Po sikur të ketë antraks aty? Ose të përdoren armët biologjike? Gaz nervoparalizues.

I shpjegova babit që metrotë nuk punonin. Ndoshta as trenat.

- Vij unë të marr, - u përgjigj. - Po hipi që tani në makinë.

- Mos u shqetëso për mua! - e qetësova. - Jam me disa shokë. Jemi shumë mirë. Do të të telefonoj përsëri më vonë. - Ende nuk arrija ta besoja atë që kishte ndodhur.

- Dëgjoni! - foli Skoti pasi mbylla telefonin. - Nëse do të isha një organizatë terroriste, do të hidhja një bombë.

- Çfarë dreqin thua kështu? - ia ktheu Adami. Ai po priste të dëgjonte ndonjë lajm nga daja i tij, që punonte në Departamentin e Policisë së Nju-Jorkut.

- Nëse e mendon nga pikëpamja akademike..., - nisi të shpjegonte Skoti, por nuk mundi të vazhdonte më tej.

- Qepe! - u nxeh Xhastini. - Seriozisht e ke Skot? Nuk është momenti i duhur...

- Më duhet të iki, - t'u drejtova ty. Në të vërtetë, nuk të njihja fare. Sapo kisha takuar shokët e tu. - Shoqet e mia të dhomës ndoshta po vrasin mendjen ku kam përfunduar.

- Telefonoji! - ma ktheve duke më zgjatur telefonin.
- Dhe thuaji që do të shkosh te tarraca e konviktit
“Vjenez”. Mund të takoheni aty nëse do.

- Ku do të shkoj?

- Do të shkojmë bashkë, - u përgjigje dhe, i hutuar, i kalove gishtat nëpër gërshetin tim. Ky ishte një gjest intim, diçka që ndodh pasi janë kapërcyer të gjitha pengesat e hapësirës personale. Ishte si të haje pjatën e dikujt tjetër pa e pyetur. Befas, u ndjeva e lidhur me ty, sikur dora jote mbi flokët e mi të nënkuptonte diçka më tepër sesa thjesht disa gishta nervozë.

E kujtova atë moment vite më vonë, kur vendosa t’i dhuroja flokët dhe stilistja më zgjati gërshetin ngjyrëkafe, të mbështjellë në një qese plastike, i cili dukej edhe më i errët se zakonisht. Edhe pse atëherë ishe në anën tjetër të botës, ndjeva sikur po të tradhtoja, sikur po e shkëpusja lidhjen tonë...

Por, atë ditë, pasi më preke flokët, kuptove çfarë kishe bërë dhe e lëshove dorën mbi prehrin tënd. Më buzëqeshe sërish, por kësaj here buzëqeshja nuk u pasqyrua në sytë e tu.

Mblodha supet.

- Dakord, - mërmërita.

Bota dukej sikur po copëtohej... dukej si një pasqyrë e thyer, ku brenda saj, asgjë nuk kishte më kuptim... mburojat tona ishin ulur, muret tona ishin shkatërruar. Në një vend të tillë, nuk kishte ndonjë arsye për të thënë “jo”.

3

Morëm ashensorin për te kati i njëmbëdhjetë i konviktit “Vjenez”. Pastaj, hape një dritare në fund të korridorit.

- Ma tregoi një student i vitit të dytë, - më shpjegove. - Këtu është pamja më fantastike e qytetit të Nju-Jorkut që ke parë ndonjëherë.

Dolëm nga dritarja në tarracë. Mbeta pa frymë... Tymi, që vinte nga maja jugore e *Manhatanit*, ngjitej lart shtëllunga-shtëllunga. I gjithë qielli po bëhej gri. Qyteti ishte mbuluar me hi.

- O Zot, - u tmerrova. Sytë m'u mbushën me lot. Përfytyrova si kishte qenë gjithçka më parë. Pashë hapësirën ku kishin qenë kullat. Por pastaj, u përmenda. Kishte njerëz brenda atyre ndërtesave.

Dora jote gjeti timen dhe e shtrëngoi fort.

Nuk e di sa gjatë qëndruam atje, duke vështruar të përhumbur pasojat e shkatërrimit, teksa lotët na rridhnin në faqe. Duhet të kishte pasur edhe njerëz të tjerë atje lart me ne, por nuk kujtoj dot askënd. Vetëm ty. Dhe imazhin e atij tymi. Vetëm këto më janë ngulitur në mendje.

- Ç'do të bëhet tani? - pëshpërita më në fund. Kjo pamje e tmerrshme më bëri të kuptoj përmasat e sulmit. - Çfarë do të ndodhë?

E ktheve vështrimin nga unë dhe sytë tanë ende me lot, u mbërthyen me një lloj magnetizmi, që e shpërfill botën rreth tij. Dora jote rrëshqiti mbi belin tim. U ngrita në majë të gishtave për t'iu afruar buzëve të tua. I ngjeshëm trupat te njëri-tjetri, sikur kjo do të na ruante nga gjithçka që do të vinte më pas. Sikur e vetmja mënyrë për të qenë e mbrojtur ishte t'i mbaja buzët mbi të tuat. Dhe në çastin që trupi yt mbështolli timin, ashtu u ndjeva vërtet, e mbrojtur nga fuqia dhe ngrohtësia e krahëve të tu. Muskujt të fërgëllonin nën duart e mia. I futa gishtat në flokët e tu, ndërsa ti e mbështolle gërshetin tim rreth pëllëmbës sate dhe e tërhoqe, duke ma përkulur kokën prapa. Dhe unë e harrova botën... Në atë moment ishe vetëm ti...

Për vite të tëra jam ndier fajtores për këtë. Fajtores që u puthëm për herë të parë, kur qyteti po digjej, fajtores që në atë çast kisha mundur të humbisja në krahët e tu. Por, më vonë, mësova që nuk ishim të vetmit. Njerëzit më treguan duke pëshpëritur që kishin bërë seks atë

ditë. Kishin ngjizur fëmijë. Ishin fejuar. Kishin thënë “të dua” për herë të parë. Vdekja çuditërisht u nxit njerëzve dëshirën për të jetuar. Donim të jetonim atë ditë dhe për këtë nuk fajësoj asnjërin prej nesh. Jo më...

Kur u ndalëm për të marrë frymë e përkula kokën mbi kraharorin tënd. Dëgjova zemrën tënde dhe u qetësova nga rrahjet e saj të rregullta.

Po rrahjet e mia të qetësuan ty? Vazhdojnë ta bëjnë këtë?

4

U kthjem në dhomën tēnde të konviktit, sepse mē ftove për drekē. Mē the qē, pasi tē hanim, kishe dēshirē tē shkonim sērish te tarraca për tē bērē disa fotografi me aparatit tēnd.

- Për revistēn “The Spectator”? - tē pyeta.

- Jo, jo, për vete, - u pērgjigje.

Nē kuzhinē, mē tērhoqēn vēmendjen një mori fotografish bardhezi, tē marra nē tē gjithē kampusin universitar. Ato ishin tē bukura, tē pazakonta, gjithē dritē. Imazhe tē zmadhuara nga një distancē aq e largēt, saqē një objekt i zakonshēm dukej si art modern.

- Ku e ke fotografuar kētē? - Pasi ia ngula sytē një copē herē, kuptova qē ishte foleja e një zogu, e mbēshtjellē me gazeta dhe revista, si dhe me një ese për orēn e letērsisē franceze.

- Oh, kjo është e jashtëzakonshme, - ma ktheve.
- E njeh Xhesika Çon? Atë që këndon muzikë kishtare? Të dashurën e David Blumit? Ajo më tregoi për këtë fole, që e dallonte nga dritarja e saj. Dikush kishte punuar aty brenda për një detyrë shtëpie. Kështu vajta ta shikoja vetë. M'u desh të përkulesha jashtë dritares për ta bërë këtë fotografi. Xhesi e detyroi Davidin të më mbante nga kyçet e këmbëve, sepse kishte frikë mos bija. Dhe ja, ku është fotografia.

Pas asaj historie m'u duke ndryshe. I guximshëm, trim, i përkushtuar në artin tënd. Tani që e sjell ndër mend, besoj se, pikërisht këtë doje që të mendoja. Po përpiqeshe të më habitje, por në atë çast, nuk e kuptova. Thjesht mendova: "Uau! Sa i mrekullueshëm është!". Por ajo që ishte e vërtetë atëherë dhe ka qenë e vërtetë për sa kohë që të njoh, është se ti e gjen të bukurën kudo. Ti vëren gjëra që të tjerët nuk munden. Për këtë të kam admiruar gjithnjë.

- Kjo është ajo që dëshiron të bësh? - të pyeta pastaj, duke të treguar me dorë fotografitë.

Tunde kokën.

- Është thjesht një pasion, - m'u përgjigje. - Mamaja ime është artiste. Duhet t'ia shohësh pikturat abstraksioniste që bën. Janë të mahnitshme. Por ama, të ardhurat i siguron duke pikturuar perëndimet e diellit në Arizona, nëpër pëlhura të vogla për turistët. Nuk e dua atë lloj jete, të krijoj atë që shitet.

U përkula te banaku për të vështruar pjesën tjetër të fotografive: njollat e ndryshkut mbi një stol guri, damarët e plasaritur të mermerit, gërryerjen në një parmak hekuri. E bukura ishte atje ku nuk e kisha imagjinuar kurrë se mund të ishte...

- Edhe babanë artist e ke? - të pyeta.

Fytyra jote u ngrys, si të ishte përplasur një derë pas syve të tu...

- Jo, nuk është, - mërmërite.

Isha penguar në një gropë, që nuk e dija se ndodhej atje. E fiksova atë pamje. Po zbuloja peizazhin tënd. Shpresoja të ishte një terren që do ta mësoja mirë, për t'u orientuar në të.

Të dy heshtëm një copë herë. Televizori ende ndihej në sfond. Dëgjova spikerët e lajmeve të flisnin për Pentagonin dhe për avionin që u rrëzua në Pensilvani. Më pushtoi sërish frika për situatën e llahtarshme. I lashë fotografitë mbi banak. Dukej diçka perverse të përqendroheshe tek e bukura në ato çaste. Por tani, që e mendoj sërish, ndoshta ishte pikërisht ajo që duhej bërë.

- Sikur the që do të hanim drekë? - të pyeta edhe pse nuk isha e uritur, edhe pse imazhet në ekranin e televizorit ma kishin trazuar stomakun...

Dera, pas syve të tu, u hap...

- Po, ashtu të thashë, - fole duke pohuar me kokë.

E vetmja gjë që mund të përgatitnim me ato që ndodheshin në kuzhinë, ishin brusketat *nachos*.

Kështu, në mënyrë mekanike, preva domatet në feta dhe hapa një konservë fasulesh me një hapëse të ndryshkur konservash. Ti vendose *tortilla* në një nga ato tabakatë njëpërdorimshme dhe djathë të grirë në një tas drithërash të ciflosur.

- Po ti? - më pyete sikur biseda jonë të mos kishte devijuar pak më parë.

- Çfarë? - E ngjesha kapakun e konservës mbi fasule, në mënyrë që të mund ta ngrija lart.

- Po ti, je artiste?

E lashë kapakun e konservës mbi banak.

- Jo, - ta ktheva. - E vetmja gjë krijuese që bëj, janë tregimet që shkruaj për shoqet e dhomës.

- Për çfarë? - më pyete me kokën të përkulur në njërën anë.

Ula sytë që të mos e dalloje skuqjen time.

- Kjo është e sikletshme, - mërmërita. - Ato flasin për një derrkuc të vockël që quhet Hamilton, i cili aksidentalisht u pranua në një koleg për lepuj.

Qeshe i habitur.

- Hamiltoni. Një derrkuc, - fole i çuditur. - Më duket shumë argëtuese.

- Faleminderit, - fola duke të vështruar sërish.

- Pra, këtë do që të bësh pasi të diplomohesh? - Zgjate dorën për të marrë kavanozin e salcës dhe e godite lehtë kapakun e tij te syprina e banakut për ta liruar.

Tunda kokën.

- Nuk besoj se ka ndonjë kërkesë të madhe në treg për tregimet e “Derrkucit Hamilton”. Kam menduar të merrem me reklamat, por tani që po e them më duket qesharake.

- Pse qesharake? - pyete, teksa e rrotullove kapakun dhe e hape me një zhurmë të mbytur.

I hodha një sy televizorit.

- A ka vërtet kuptim kjo? Të merresh me reklama? Nëse kjo do të ishte dita ime e fundit në këtë botë, dhe do ta kisha kaluar tërë jetën duke organizuar fushata reklamash për t’u shitur njerëzve djathë të grirë apo brusket *nachos*... a do të ndihesha vallë sikur e kisha harxhuar si duhet kohën në këtë jetë?

Kafshove buzën. Sytë e tu dukej sikur thoshin: “Për këtë po mendoj”. Mësova diçka tjetër lidhur me topografinë tënde. Ndoshta ti mësove pak nga e imja.

- Kur jeta mund të konsiderohet “e jetuar siç duhet”? - më pyete.

- Këtë po përpiqem të kuptoj, - nisa të të shpjegoja, duke u menduar teksa flisja. - Them se ndoshta ka të bëjë me faktin që duhet të lësh gjurmë... Ta lësh botën në një gjendje pak më të mirë sesa e gjete. Ende e besoj këtë, Geib. Për këtë kam luftuar gjatë gjithë jetës sime. Mendoj se edhe ti e ke bërë.

Pashë fytyrën tënde të çelej në atë çast. Nuk isha e sigurt se çfarë nënkuptonte kjo. Nuk dija ende të të lexoja mirë. Por tani e njoh atë vështrim. Do të thotë që perspektivat po ndryshojnë në mendjen tënde.

Ngjeve një patatinë te salca pikante dhe ma zgjate.
- Do pak?

E theva me dhëmbë përgjysmë. Pjesën tjetër e fute me shpejtësi në gojën tënde. Sytë e tu po studionin relievin e fytyrës sime e më pas zbritën përgjatë trupit tim. Po më ekzaminoje nga kënde të ndryshme dhe pozicione të favorshme. Pastaj më preke faqen me majat e gishtave. U puthëm sërish; kësaj here ndjeva shijen e kripës dhe të specit djegës.

Kur isha pesë apo gjashtë vjeçe, vizatoja në murin e dhomës sime me një shkumës të kuq. Nuk mendoj se ta kam treguar ndonjëherë këtë histori. Dhe, teksa vizatoja zemra, pemë, diej, hëna dhe re, e dija që po bëja diçka që nuk duhet ta bëja. E ndieja në fund të stomakut. Por nuk e ndalja dot veten. Më pëlqente aq shumë ta bëja. Dekorimet e dhomës sime ishin ngjyrë rozë dhe të verdhë, por ngjyra ime e preferuar ishte e kuqja. Dhe doja që dhoma ime të ishte e kuqe. Dëshiroja aq shumë që dhoma ime të ishte e kuqe. Tek vizatoja mbi mur, më dukej diçka plotësisht e drejtë dhe absolutisht e gabuar në të njëjtën kohë.

Kështu u ndjeva ditën që të takova ty. Tek të puthja në mes të tragjedisë, më dukej plotësisht e drejtë dhe absolutisht e gabuar në të njëjtën kohë. Por unë u përqendrova në pjesën që dukej e drejtë, ashtu si bëj gjithnjë.

Rrëshqita dorën në xhepin e prapmë të xhinseve të tua, ndërsa ti rrëshqite dorën në timin. E tërhoqëm njëri-tjetrin më pranë. Ra zilja e telefonit në dhomën tënde, por ti e shpërfille. Pastaj u dëgjua zilja e telefonit në dhomën e Skotit.

Pak sekonda më vonë, Skoti hyri në kuzhinë dhe pastroi fytin. U shkëputëm menjëherë nga njëri-tjetri dhe u kthyem nga ai.

- Të kërkon Stefania, Geib, - tha. - Po të pret në linjë.

- Stefania? - pyeta.

- Askush, - ma ktheve, ndërsa Skoti shtoi: - Ishi.

- Po qan, o burrë, - vazhdoi Skoti.

Nuk po vendosje dot. Sytë e tu shkonin nga Skoti tek unë dhe përsëri te Skoti.

- A mund t'i thuash se do ta telefonoj për pak minuta?

Skoti pohoi me kokë dhe u largua. Pastaj më rrëmbeve dorën, duke kryqëzuar gishtat e tu me të mitë. Vështruam njëri-tjetrin ashtu si te çatia dhe unë nuk munda t'i hiqja dot sytë nga ti. Zemra nisi të më rrihte fort.

- Lusi, - mërmërite, dhe nga mënyra si e shqiptove emrin tim, dukej sikur më dëshiroje. E di që je këtu, e di që kjo mund të të duket pa kuptim, por më duhet të marr vesh si është ajo. Kemi qenë të lidhur vitin e kaluar shkollor dhe u ndamë para një muaji. Kjo ditë...

- Të kuptoj, - u përgjigja. Dhe çuditërisht, kjo më bëri të të pëlqeja më shumë, sepse ndonëse nuk dilje më me Stefaninë, ende kujdeseshe për të. - Edhe mua më duhet të kthehem te shoqet e dhomës, - të sqarova, megjithëse nuk doja të ikja. - Faleminderit për... - E fillova fjalinë pa ditur si ta përfundoja dhe pastaj kuptova se nuk po mundesha ta vazhdoja.

Më shtrëngove gishtat.

- Të falënderoj që i dhe kuptim kësaj dite për mua. Lusi. *Luce. Luz* do të thotë “dritë” në spanjisht, apo jo? - Heshte. Pohova me kokë. - Të falënderoj që e mbushe me dritë këtë ditë të errët.

Më the me fjalë një ndjenjë, që unë nuk po e shprehja dot.

- Edhe ti bëre të njëjtën gjë për mua, - ta ktheva. - Faleminderit.

U puthëm përsëri dhe e pata të vështirë të shkëputesha nga ti. E pata shumë të vështirë të largohesha.

- Do të të telefonoj më vonë, - më sqarove. - Do të ta gjej numrin në numërorin telefonik. Më vjen keq që nuk i përfunduam brusetat *nachos*.

- Kujdesu për veten! - u përgjigja. - Mund t’i hamë një herë tjetër brusetat *nachos*.

- Ke të drejtë!

U largova duke pyetur veten nëse ishte e mundur që, në një nga ditët më të tmerrshme të jetës sime, të përjetoja një lloj ndjesie kaq të veçantë...

Më telefonove pak orë më vonë, por biseda jonë nuk ishte ajo që prisja. Më the se të vinte keq, shumë keq, por ti dhe Stefania ishit kthyer së bashku. Vëllai i saj më i madh, që punonte te Qendra Tregtare Botërore 1, ishte raportuar i humbur. Ajo kishte nevojë për ty. Më the se shpresoje të të kuptoja dhe më falënderove sërish që ta ndriçova atë pasdite të llahtarshme. Më the se e konsideroje shumë të rëndësishëm faktin që kisha qenë atje me ty. Dhe më kërkove edhe një herë të falur.

Ajo telefonatë më dërrmoi...

Nuk të fola gjatë pjesës tjetër të semestrit të vjeshtës. As gjatë semestrit të pranverës. Ndryshova vendin në orën e Kramerit, që të mos ulesha ngjitur me ty. Por të dëgjova çdo herë që fole për mënyrën se si e shikoje të bukurën në gjuhën dhe figuracionin e Shekspirit, madje edhe në skenat e shëmtuara.

Lexoje me zë të lartë:

- *Eh!*

*Një lumë flakë i kuq me gjak të ngrohtë,
si një burim gurgullues i trazuar nga era,
u ngrit e ra në buzët e tua bojëtrëndafili.*

Gjithçka që mendoja ishin buzët e tua, që i ndieja të ngjeshura pas buzëve të mia.

U përpoqa ta harroj atë ditë, por ishte e pamundur. Nuk munda ta harroj atë që i ndodhi Nju-Jorkut, Amerikës, njerëzve brenda kullave. Dhe nuk munda

ta harroj atë që ndodhi mes nesh. Edhe tani, sa herë që dikush pyet: “Ishe në Nju-Jork kur u rrëzuan kullat?” apo “Ku ishe atë ditë?” apo “Si ishte Nju-Jorku atë ditë?”, gjëja e parë që mendoj, je ti...

Ka momente, që e ndryshojnë trajektoren e jetës së njerëzve. Për shumë nga ne, që jetonin në qytetin e Nju-Jorkut atëherë, 11 Shtatori ishte një nga këto momente. Çdo gjë që bëra atë ditë, do të kishte rëndësi për mua, do të më ngulitej në mendje e në zemër. Nuk e di pse të takova ty atë ditë, por di që do të bëheshe pjesë e historisë së jetës sime përgjithmonë.

Ishte maj dhe sapo ishim diplomuar. Kishim dorëzuar kapelat dhe veshjet në këmbim të diplomave të shkruara në latinisht, të zbukuruar me emrat dhe mbiemrat tanë. U futa në restorantin “Le Monde”, e shoqëruar nga mami, babi, vëllai im, Xheisoni, dy gjyshërit dhe daja. Familjen time e ulën pranë një familjeje shumë më të vogël, që ishte e jotja.

Ngrite sytë teksa ne ecnim njëri pas tjetrit dhe zgjate dorën për të më prekur te krahu.

- Lusi! Urime!

U drodha. Pas gjithë këtyre muajve, të ndieja lëkurën tënde pranë simes, ishte vërtet rrëqethëse, por e mblodha veten sa për të të thënë:

- Edhe ti!

- Çfarë do të bësh? - më pyete. - Do të qëndrosh në qytet?

Pohova me kokë.

- Do të filloj punë në një kompani të re produksioni televiziv. Bëhet fjalë për programet e fëmijëve.

Më shkoi buza vesh më vesh. Ishte një punë për të cilën kisha pritur me shpresa për rreth dy muaj, derisa e fitova. Një punë, për të cilën kisha nisur të mendoja menjëherë pas rrëzimit të kullave, pasi kisha pohuar se doja të bëja diçka më të rëndësishme sesa reklamat. Një punë, që do të ishte e vlefshme edhe për brezin tjetër dhe do të kishte potencialin të ndryshonte të ardhmen.

- Programet për fëmijë? - pyete teksa një buzëqeshje lodronte në buzët e tua. - Si “Alvini dhe ketrat”? Do të kenë zëra metalike?

- Jo tamam, - të sqarova dhe vura buzën në gaz, duke dashur të të tregoja se biseda jonë më kishte shtyrë në atë drejtim, se ato momente, që kaluam në kuzhinën tënde, për mua patën vërtet rëndësi. - Po ti?

- “McKinsey”. Konsulencë. Nuk do të kem ketra përreth.

U habita. Nuk e prisja këtë pas bisedës që kishim bërë, pas analizave të tua në orën e Kramerit.

Por fjalët që të thashë ishin:

- Shkëlqyeshëm! Urime për punën! Ndoshta do të të shoh ndonjëherë nëpër qytet.

- Sa mirë do të ishte! - u përgjigje.

Vajta të ulesha në tavolinë me familjen time.

- Kush ishte ajo? - dëgjova dikë të të pyeste. Ngrita sytë. Pranë teje, ishte ulur një vajzë me flokë të gjatë deri te mesi i shpinës, të lyer ngjyrë gruri, e cila e kishte vënë dorën mbi kofshën tënde. Në fakt nuk e fiksova; isha shumë e fokusuar te ti.

- Një vajzë që e kam pasur në klasë, Stefani, - dëgjova t'i përgjigjeshe. Në të vërtetë, ashtu isha. Por nuk e di pse kjo më lëndoi...

6

Nju-Jorku është një qytet i çuditshëm. Mund të kesh vite që jeton atje dhe mund të mos e shohësh kurrë fqinjin e shtëpisë ngjitur. Mund të takosh shoqen tënde të ngushtë, teksa hipën në metro, për të shkuar në punë. Fati përkundrejt dëshirës. Ndoshta të dyja bashkë.

Ishte mars. Kishte kaluar pothuajse një vit që kur ishim diplomuar dhe qyteti i Nju-Jorkut na kishte përpirë... Jetoja me Keitin në pjesën e sipërme lindore të *Manhatanit*, në një apartament shumë të madh, që dikur i përkiste gjyshërve të saj. Ishte diçka që e kishim planifikuar ta bënim që kur ishim në shkollë të mesme. Dhe ëndrrat tona të fëmijërisë tashmë ishin bërë realitet.

Pata një lidhje me një koleg për gjashtë muaj, nja dy lidhje të tjera që kishin zgjatur vetëm nga një

natë, si dhe kisha dalë në pak takime me meshkuj, të cilët nuk më ishin dukur mjaftueshëm të zgjuar, apo mjaftueshëm të bukur, apo mjaftueshëm seksi, ndonëse kur i gjykoja më pas, nuk u gjeja asnjë të metë. Në të vërtetë, nëse do ta kisha takuar Derenin atëherë, edhe për të mund të kisha menduar të njëjtën gjë.

Tani që nuk shkoja më në sallën e Filozofisë, apo nuk kaloja nga konviktet e kampusit lindor, pothuajse nuk të mendoja më. Nuk e kishim parë njëri-tjetrin përreth një vit. Por ti shfaqeshe papritur në mendjen time gjatë punës, kur unë dhe shefi u hidhnim një sy ilustrimeve dhe imazheve të programit, apo kur rishikonim episodet. Mendoja për kuzhinën tënde dhe ndihesha mirë për vendimin që kisha marrë.

Ishte e enjte, 20 mars, dhe unë mbushja njëzet e tre vjeçe. Kisha planifikuar një festë në fundjavë, por dy shoqet e mia më të ngushta në punë, Aleksii e Zyrës së Shkrimtarëve dhe Xhulia e Departamentit të Artit, siç i thërrisje ti më vonë, kërkuan me ngulm që të pinim diçka atë ditë.

Gjatë dimrit, të tria ishim fiksuar pas barit “Faces & Names”, për shkak të vatrës dhe mindereve. Temperatura luhatej rreth pesë gradë, por menduam se ata mund ta ndiznin vatrën, nëse do t’ua kërkonim. Kishim qenë shumë herë atje, gjatë muajve të fundit, dhe baristi na pëlqente.

Xhulia më kishte bërë një kurorë letre për ditëlindje dhe nguli këmbë që ta vija, ndërsa Aleksii porositi

martini me mollë për të tria. U ulëm te minderi pranë vatrës, duke ngritur dolli përpara çdo gllënjke që pinim.

- Për ditëlindjet! - filloi Aleksi.

- Për Lusin! - vazhdoi Xhulia.

- Për shoqet! - shtova unë.

Pastaj dollitë degjeneruan paksa: “Për makinën e fotokopjes që nuk u bllokua sot!”, “Për shefat që telefonojnë se janë sëmurë e nuk vijnë dot në punë!”, “Për drekat falas pas takimeve të nivelit të lartë!”, “Për baret me vatra!” dhe “Për martinin me mollë!”.

Kamerierja erdhi te minderi ynë me një tabaka, në të cilën ndodheshin tre martini të tjerë.

- Oh, nuk i kemi porositur këto, - u çudit Xhulia.

Kamerierja buzëqeshi.

- Ju vajza keni një admirues të fshehtë. Ajo bëri shenjë me kokë nga banaku.

Dhe aty ishte ti...

Për një çast mendova se kisha halucinacione.

Na përshëndete duke tundur lehtë dorën.

- Më tha që i uron Lusin “Gëzuar ditëlindjen!”.

Alexi mbeti me gojëhapur.

- E njeh? Qenka seksi!

Pastaj mori një nga tre martinit, që kamerierja kishte vendosur mbi tavolinë përpara nesh.

- Për djemtë simpatikë në bare, që e dinë emrin tënd dhe na dërgojnë pije falas! - ngriti ajo një dolli.

Pasi të gjitha pimë nga një gllënjë, shtoi: - Shko falënderoje ti vajza që ke ditëlindjen!

E vendosa martinin mbi tavolinë, por pastaj ndryshova mendje. E mora me vete dhe eca në drejtimin tënd, duke u tundur paksa mbi takat e mia të larta.

- Faleminderit, - të thashë, duke u ulur në stol, në të majtën tënde.

- Gëzuar ditëlindjen! - ma ktheve. - Sa kurorë e bukur!

Qesha dhe e hoqa.

- Ty mund të të shkojë më shumë. Do ta provosh?

E vure në kokë. Kaçurrelat e tua u shtypën nga kurora.

- Dukesh i mahnitshëm.

Buzëqeshe dhe e vendose kurorën mbi banakun përpara nesh.

- Mezi të njoha, - vërejte. - Seç u ke bërë flokëve.

- Balluke, - të thashë, duke i vënë në njërën anë.

M'i ngule sytë, ashtu si kishe bërë në kuzhinën tënde, duke më parë nga të gjitha këndet.

- Je e bukur me dhe pa balluke. - Fjalët nuk i thoshe të plota. Kuptova se ishe edhe më i pirë se unë. Kjo më shtyu të vrisja mendjen, pse ishe vetëm dhe i dehur në orën shtatë, mbrëmjen e një të enjteje.

- Si je? Çdo gjë në rregull?

E vure bërrylin mbi banak dhe e mbështete faqen në dorën tënde.

- Nuk e di. Unë dhe Stefania u ndamë sërish. E urrej punën time. Shtetet e Bashkuara pushtuan Irakun. Sa herë të takoj ty, diçka e keqe po ndodh në këtë botë...

Nuk dija si t'i përgjigjesha informacionit që më dhe për Stefaninë, e as pohimit tënd për të këqijat që ndodhnin në këtë botë, prandaj piva një tjetër gllënjë nga martini im.

Ti vazhdove:

- Ndoshta, universi e dinte që kisha nevojë të të gjeja ty sonte. Ti je si... Pegasi.

- Unë jam një kalë me krahë, si tek "Iliada"? - të pyeta. - Një kalë mashkull me krahë?

- Jo, - u përgjigje. - Je pa dyshim, femër.

Buzëqesha.

- Por, Belerofoni nuk do ta kishte mundur kurrë Kimerën pa Pegasin. Pegasi e ndihmoi shumë atë, - më shpjegove. - Ai arriti të fluturonte pavarësisht gjithçkaje: dhimbjes, plagëve. Dhe u bë një hero i madh.

Nuk e kisha kuptuar kështu mitin. Kisha menduar se ai e vinte theksin te bashkëpunimi dhe partneriteti. Më kishte pëlqyer gjithnjë fakti që Pegasi duhej t'i jepte leje Belerofonit për ta kalëruar. Por shpjegimi që ti bëre, dukej tepër i rëndësishëm për ty.

- Faleminderit për komplimentin. Ndonëse do të kisha preferuar të më krahasoje me Athinanë. Herën. Madje edhe me Gorgon.

Cepat e buzëve të tua u përdrodhën.

- Jo me Gorgon. Nuk ka gjarpërinj në kokën tënde.
Preka flokët e mi.

- Nuk më ke parë si dukem kur zgjohem në mëngjes.

Më vështrove sikur ta dëshiroje vërtet këtë.

- A të thashë ndonjëherë që më erdhi shumë keq?
- më pyete. - Për atë që ndodhi. Me ne. Nuk më vjen keq që të putha. Por... - ngrite supet. - Më vjen keq për atë që ndodhi më pas. U përpoqa të bëja gjënë e duhur. Me Stefaninë. Jeta është...

- E ndërlikuar, - e përfundova fjalinë për ty. - Mos u shqetëso! Ka kaluar shumë kohë tashmë. Dhe më ke kërkuar falje. Dy herë.

- Ende mendoj për ty, Lusi, - mërmërite, duke vështruar gotën bosh të uiskit. Pyeta veten sa të tilla mund të kishe pirë. - Mendoj për atë degëzimin e rrugës... çfarë do të kishte ndodhur nëse do ta kishim ndjekur së bashku... Por ne ishim dy rrugë që u ndanë...

Tani do të qeshja po të më krahasoje me një rrugë, por atëherë më dukej aq romantike kur më citoje Robert Frostin.

I hodha një sy Aleksit dhe Xhulias. Ato po na shikonin teksa pinin martinit e tyre. "Mirë je?", tha Xhulia duke lëvizur buzët. Pohova me kokë. Trokiti lehtë mbi orën e saj dhe mblodhi supet. Iu përgjigja duke ngritur supet edhe unë. Ajo tundi kokën.

Hodha vështrimin nga ti. Ishe i bukur, delikat dhe më dëshiroje. Ndoshta kjo ishte dhurata që universi më kishte bërë për ditëlindje.

- E bukura për rrugët, - vëreja, - është se nganjëherë rastis sërish në to. Nganjëherë të jepet një tjetër mundësi të ecësh në të njëjtën rrugë.

O Zot sa të brishtë ishim... Ose ndoshta ishim thjesht të rinj. Shumë, shumë të rinj.

Më dhe një vështrim magnetik me sytë e tu blu.

- Do të të puth, - mëmërite, teksa u përkule drejt meje. Dhe kur e bëre, mendova se dëshira ime në atë ditëlindje më ishte plotësuar...

- Do të vish sonte në apartamentin tim, Lusi? - më pyete, ndërsa fute një tufë të pabindur flokësh pas veshit tim. - Nuk dua të iki në shtëpi vetëm.

Dallova trishtimin në sytë e tu... vetminë. Doja të bëja diçka për ty, të isha shpëtimi yt, fasha jote, ilaçi yt. Gjithnjë kam dashur t'i rregulloj gjërat për ty. Ende dua. Është thembra ime e Akilit. Ose ndoshta fara ime e shegës. Është ajo që më tërheq prapa, ashtu si Persefonin.

I ngrita gishtat e tu mbi buzët e mia dhe i putha.

- Po, - u përgjigja. - Do të vij.

Qëndronim të shtrirë mbi shtratin tënd, teksa trupat tanë ndriçoheshin vetëm nga dritat e qytetit, që hynin brenda nga grilat. Më kishe mbështjellë në krahët e tu, ndërsa dorën e kishe vendosur mbi barkun tim të zhveshur. Ishim të lodhur, të velur, dhe ende pak të dehur.

- Dua ta lë punën, - pëshpërite, sikur errësira të jepte siguri për ta thënë me zë të lartë.

- Në rregull, - pëshpërita edhe unë përgjumësh. -
Lëre!

Fërkove gishtin e madh të dorës në anën e poshtme të gjoksit tim.

- Dua të bëj diçka që ka kuptim, - mërmërite. Ndjeva frymën tënde të ngrohtë në qafën time. -
Ashtu siç the edhe ti.

- Mmm, - u përgjigja e përgjumur.

- Por atëherë nuk e kuptova.

- Çfarë nuk kuptove? - fola mbyturazi.

- Nuk mjafton vetëm të gjesh të bukurën, - vërejte dhe fjalët e tua më mbajtën zgjuar. - Dua të fotografoj gjithçka: lumturinë, trishtimin, gëzimin, shkatërrimin. Dua të tregoj histori me aparatim tim fotografik. Ti më kupton, apo jo, Lusi? Stefania nuk më kuptonte. Por ti ishe atje. Ti e di se ajo që ndodhi, e ndryshoi pikëpamjen tonë për botën.

U ktheva me fytyrë nga ti dhe të dhashë një puthje të ëmbël.

- Sigurisht që të kuptoj, - pëshpërita përpara se të ikja në gjumë.

Por, në të vërtetë, nuk e kuptova atë që doje të thoshe dhe nuk e dija sa larg do të të çonte... Nuk e dija që do të të sillte deri këtu... Isha e pirë, e lodhur dhe, më në fund, në krahët e tu, ashtu si kisha imagjinuar aq shumë herë. Në ato çaste, do të kisha rënë dakord me çdo gjë që do të më kishe kërkuar.

8

E le punën për të bërë një kurs për fotograf. Vazhduam të takoheshim dhe sa më shumë kohë kalonim së bashku, aq më e fuqishme bëhej lidhja jonë fizike, teksa gjenim ngushëllim, shpresë, forcë, në krahët e njëri-tjetrit. Zhvisheshim në banjat e restoranteve, sepse nuk mund të prisnim derisa të arrinim në shtëpi. Putheshim me pasion nëpër cepat e ndërtesave dhe ndienim tullat nëpër supe, ndërsa buzët tona takoheshin. Shkonim për piknik në park. Shishet bosh të lëngut të mollës i mbushnim me verë të bardhë dhe qëndronim të shtrirë, duke thithur aromën e barit të sapoprerë dhe të njëri-tjetrit.

- Më thuaj diçka më tepër për babanë tënd, - të kërkova pak muaj pasi ishim rilidhur, duke guxuar pak si tepër...

- Nuk kam shumë për të thënë, - u përgjigje, duke ndryshuar pozicionin dhe koka ime përfundoi mbi kraharorin tënd. Zëri yt ishte ende i butë, por arrita ta ndieja tendosjen e muskujve të tu. - Ai është trap.

- Pse është trap? - të pyeta, duke u kthyer në mënyrë që të të mbështillja me krahun tim, për të të afruar më pranë vetes. Nganjëherë kisha ndjesinë që nuk do të ishim kurrë shumë të afërt. Dëshiroja të hyja brenda lëkurës sate, brenda mendjes sate, që të merrja vesh gjithçka që duhet të dija për ty.

- Babai im ishte... i paparashikueshëm, - fole ngadalë, sikur e zgjodhe atë fjalë me shumë kujdes. - Kur isha mjaftueshëm i rritur, nisa ta mbroja nënën time.

Ngrita kokën nga kraharori yt dhe të vështrova. Nuk isha e sigurt çfarë duhet të të thosha, sa shumë duhet të të pyesja. Doja të dija cilën moshë nënkuptoje me “mjaftueshëm i rritur”. Katër? Dhjetë? Trembëdhjetë?

- Oh, Geibi! - ishin fjalët që më dolën. Më vjen keq që nuk të thashë diçka më tepër.

- Ai dhe mami u takuan në shkollën e artit. Ajo mendonte se skulpturat e tij ishin të bukura, por unë kurrë nuk pashë ndonjë nga punët e tij. - U gëlltite me vështirësi. - I shkatërroi të tëra një e nga një, menjëherë pasi linda unë. Dëshironte të projektonte monumente, vepra gjigante. Por askush nuk po bënte ndonjë porosi, askush nuk po e blinte artin e tij.

U ktheve për të më vështruar.

- Duhet të ketë qenë e vështirë për të. Nuk mund ta imagjinoj...

Tunde kokën.

- Ai hoqi dorë, - më tregove. - U përpoq të drejtonte një galeri. Por si biznesmen nuk ishte kushedi se çfarë. As si tregtar. Ishte gjithnjë i acaruar, shpërthyes. Nuk... nuk e kuptova çfarë i ndodhi kur hoqi dorë. Njëherë i shkatërroi me thikë mami një pikturë, për të cilën ajo kishte punuar muaj të tërë, sepse sipas tij, ajo duhet ta shfrytëzonte kohën duke pikturuar perëndimet e diellit. Mami qau sikur t'i kishte goditur trupin, jo thjesht artin. Ky ishte momenti kur u largua.

Rrëshqita dorën time në tënden dhe e shtrëngova fort.

- Sa vjeç ishte?

- Nëntë, - fole me butësi. - I telefonova policisë.

Fëmijëria ime kishte qenë shumë e ndryshme nga e jotja, shumë e këndshme... e shkëlqyer. Nuk isha e sigurt si duhet të të përgjigjesha. Nëse do ta kishim bërë tani atë bisedë, do ta kuptoja dhimbjen, tënden dhe të tijën. Do të të thosha që babai yt kishte kaluar një periudhë të vështirë, se ai po luftonte demonët dhe që më vinte keq që demonët e tij u bënë edhe të tutë. Sepse, në fakt, u bënë, apo jo? Ti e jetove thujse gjithë jetën tënde si përgjigje ndaj së tijës, duke u përpjekur të mos bëheshe si ai dhe përfundove duke luftuar demonët e tij dhe të tutë.

Por atë ditë, nuk munda ta përpunoj në kohë

informacionin që mora prej teje dhe doja vetëm të të qetësoja. Pasi mora frymë thellë, të thashë:

- Ke bërë gjënë e duhur.

- E di, - ma ktheve. Sytë e tu ishin të lodhur. - Kurrë nuk do të bëhem si ai. Kurrë nuk do të të lëndoj ashtu. Kurrë nuk do t'i konsideroj ëndrrat e tua si të pavlefshme.

- Edhe unë. Kurrë nuk do t'i konsideroj ëndrrat e tua si të pavlefshme, Geib, - të premtova dhe e vendosa sërish kokën mbi kraharorin tënd. I vura buzët mbi bluzën tënde dhe të putha, duke u përpjekur të të transmetoja thellësinë e admirimit dhe të ngushëllimit tim.

- E di. - Më ledhatove flokët. - Kjo është një nga shumë, shumë gjërat që adhuroj te ti.

U ngrita ndenjtur dhe të vështrova përsëri.

- Të dua, Lusi!

Ishte hera e parë që ma the. Hera e parë që një mashkull ma kishte thënë.

- Edhe unë të dua, - u përgjigja.

Shpresoj të të kujtohet ajo ditë. Është diçka që nuk do ta harroj kurrë...

9

Pak javë pasi i kishim thënë “të dua” njëri-tjetrit, ishim vetëm, të dy, në shtëpinë ku banoja unë. Kishim vendosur ta festonim atë fakt, duke u vërtitur nëpër shtëpi me të brendshme. Po na zihej fryma nga zagushia. Ishte ajo vapa mbytëse e korrikut që të bën ta kalosh gjithë ditën zhytur në pishinë. Ndonëse kondicioneri ishte hapur në maksimum, apartamenti ishte ende i nxehtë. Ishte i madh dhe ndoshta na nevojiteshin më tepër se një.

- Gjyshërit e Keitit paskan qenë gjeni për pasuritë e paluajtshme, - vërejte, kur po skuqnim vezët, gjysmë të zhveshur. - Kur e kanë blerë këtë shtëpi?

- Nuk e kam idenë, - ta ktheva, duke vendosur simitet në thekësin e bukës. - Para se të lindte i ati i saj. Pra... në vitet '40?

Fishkëlleve.

E di që nuk qëndronim shpesh atje, por jam e sigurt që të kujtohet apartamenti. Ai zor se mund të harrohej: hapësirat tepër të mëdha në dy dhomat e gjumit dhe banjat, kthina e mëngjesit që e përdornim si bibliotekë, tavanet që ishin rreth katër metra të larta. Nuk i vlerësoja këto hollësira atëherë, por ama e vlerësoja apartamentin. Kur Keiti nisi të studionte drejtësi, babai i tha se i binte më lirë të jetonte atje, sesa të paguante konviktin e *Universitetit të Nju-Jorkut*. Edhe mua më bëhej shumë mirë.

- I bëmë një vizitë gjyshes së Keitit kur ishim në shkollë të mesme, - të tregova, teksa u ulëm në divan me pjatat e mëngjesit mbi gjunjët tanë të zhveshur.

- Ajo ishte cicerone në Muzeun Metropolitan të Artit, derisa u sëmur. Kishte studiuar histori arti në kolegjin *Smith*, atëherë kur shumica e femrave as nuk e mendonin të mbaronin kolegjin.

- Sa do të doja ta kisha takuar, - the pasi pive një gllënjë kafe.

- Do ta kishe pëlqyer shumë.

Përtypeshim në heshtje, kofshët tona pranë njëra-tjetrës, ndërsa supi im kishte prekur krahun tënd. Ishte e pamundur që të ishim në një dhomë së bashku e të mos prekeshim.

- Kur kthehet Keiti? - më pyete, pasi u gëlltite.

Mblodha supet. Ajo kishte takuar Tomin rreth një muaj më parë dhe ndoshta ishte hera e dytë që qëndronte në shtëpinë e tij.

- Duhet të fillojmë të vishemi.

Ndjeva sytë e tu mbi gjoksin tim.

E le pjatën e mëngjesit mbi tryezë.

- Nuk e ke idenë çfarë më bën ti mua, Lusi, - mërmërite, duke më vështruar, teksa lashë pirunin mbi pjatë. - Gjithë mëngjesin, kështu e zhveshur... Më duket sikur po jetoj një nga fantazitë e mia. - I lëshove duart mbi prehrin tënd dhe pastaj nise të prekje veten ngadalë. Nuk të kisha parë kurrë ta prekje veten, nuk të kisha parë kurrë çfarë bëje kur ishe vetëm. Nuk munda t'i heq sytë.

- Tani ti, - më the, duke ulur me shpejtësi mbathjet.

Vendosa pjatën mbi tryezë dhe t'u afrova. Tashmë ishe eksituar.

Tunde kokën dhe buzëqeshe.

- Nuk kisha këtë në mendje.

Ngrita vetullat dhe pastaj e kuptova çfarë doje. Rrëshqita gishtat poshtë barkut. As ti nuk më kishe parë kurrë të prekja veten. Dhe kjo më emocionoi. Mbylla sytë dhe nisa të mendoj për ty, që ti po më vështroje, që po e ndaja këtë moment kaq personal me ty dhe ndjeva trupin të më dridhej.

- Lusi, - pëshpërite.

Hapa sytë duke i përpëlitur dhe të pashë tek masturboheshe më shpejt.

Më dukej më intime se seksi... ne të dy që jepnim “shfaqje”, për njëri-tjetrin. Në fakt ky akt zakonisht ishte personal. Vijat që na ndanin “ty” dhe “mua” tashmë po mjegulloheshin duke na shndërruar edhe më tepër në “ne”.

Ndërsa vazhdoja të prekja veten, u mbështete te divani, duke i hequr fare mbathjet, pa m’i ndarë sytë. Duart tona nisën të lëviznin më shpejt. Edhe frymëmarrja u përshpejtua. Kafshove buzën. Pastaj pashë ta kapje më fort. Pashë muskujt e tu të shtrëngoheshin... Pashë tek u prishe.

- O Zot, - pëshpërite. - Oh, Lusi!

I lëviza gishtat më me ngulm, por ti ma shtrëngove krahun rreth belit.

- A mundem? - më pyete.

U rrëqetha kur dëgjova zërin tënd.

Pohova me kokë. U zhvendose, në mënyrë që të shtrihesha në gjatësinë e divanit dhe kështu të mund të më hiqje të brendshmet. M’u afrove dhe unë nisa të përpëlitesha.

Teksa i rrëshqite gishtat brenda meje, më the:

- Unë kam një sekret.

- Oh, vërtet? - të pyeta dhe u përkula të gjeja dorën tënde.

- Oh, po, - u përgjigje duke u shtrirë pranë meje, me gojën mbi timen. - Sa herë e prek veten, mendoj për ty.

Një e rrëqethur më përshkoi trupin.
- Edhe unë, - pëshpërita me një frymë.
U prisha tridhjetë sekonda më vonë.

Gjatë atyre gjashtë muajve të parë, po mësoja gjithnjë gjëra të reja për ty, gjëra që më dukeshin seksi, të mahnitshme, tërheqëse.

Si atë ditë kur erdha në shtëpinë tënde pas pune dhe të gjeta të ulur këmbëkryq mbi dysheme, të rrethuar nga grumbuj letrash të vogla në formë katrorësh.

Lashë çantën mbi tryezën e kuzhinës dhe mbylla derën.

- Çfarë po bën?

- Për dy javë ka ditëlindjen mamaja ime, më nëntëmbëdhjetë shtator, - më tregove, duke ngritur sytë nga letrat që po seleksionoje. - Meqenëse këtë vit nuk mund të shkoj në shtëpi, doja t'i dërgoja diçka të rëndësishme.

- Dhe po i bën... një mozaik letrash? - të pyeta duke u afruar.

- Pak a shumë, - u përgjigje. - Këto janë të gjitha fotografi të mamit dhe të miat. - I ngrite letrat për të m'i treguar. U afrova edhe më tepër dhe pashë mamanë tënde dhe ty në ceremoninë e diplomimit në shkollën e mesme. Pastaj, ju të dy me pantallona të shkurtra, teksa këmbët i kishit futur në pishinë. Në një tjetër, po pozoje me duart prapa veshëve si lepurush, në verandën përpara shtëpisë.

- Uau! - u habita.

- Kam thujse tërë ditën që i printoj dhe tani po i sistemoj sipas ngjyrës. Dua që të duket si një kaleidoskop.

U ula në dysheme pranë teje dhe ti më dhe një puthje të shpejtë.

- Pse do që të duket si një kaleidoskop? - Mora një fotografi, ku ti dhe mamaja jote qëndronit shpinë më shpinë. Ti ishe një grimë më i gjatë. Flokët i kishe njësoj, biondë dhe kaçurrelë. Ishte e vështirë të dalloje ku mbaronte ajo dhe ku filloje ti.

- Isha katërmëdhjetë vjeç, - u përgjigje, duke parë fotografinë.

- Dukesh shumë i lezetshëm. Edhe unë isha katërmëdhjetë vjeçe atëherë dhe do të kisha luajtur mendsh pas teje.

Buzëqeshe dhe më shtrëngove fort këmbën.

- Edhe pa parë një fotografi tënden kur ke qenë

katërmbëdhjetë vjeçe, jam i bindur se edhe mua do të më kishte ndodhur e njëjta gjë.

Tani ishte radha ime të buzëqeshja. E vendosa fotografinë mbi dysHEME.

- Po pse do që të duket si një kaleidoskop? - të pyeta sërish.

Fërkove ballin me njëren dorë dhe largove kaçurrelat nga sytë.

- Nuk ia kam treguar askujt këtë histori, - fole me zë të ulët.

Mora nja dy fotografi të tjera. Ishe ti dhe mamaja jote, e cila po fikte qirinjtë mbi tortën e saj të ditëlindjes. Ndërsa te tjetra, ajo ta kishte kapur dorën teksa qëndronit në këmbë në një restorant meksikan.

- Nuk je i detyruar të ma tregosh, - ta ktheva, duke vrarë mendjen nëse fotografitë i kishte bërë babai yt para se të mbushje nëntë vjeç. Po më pas kush jua bënte?

- E di, - u përgjigje. - Por dua të ta tregoj. - U zhvendose paksa që të ishe përballë meje, gju më gju. - Një vit pasi prindërit e mi u ndanë, ishim ngushtë ekonomikisht. Kur kthehesha nga shkolla, më shpesh e gjeja mamin duke qarë sesa duke pikturuar. Atë vit, sigurisht, do të më vinte keq po të mos e festoja ditëlindjen. E megjithatë, i thashë se nuk doja të më organizonte asnjë festë me shokët. Nuk doja që ajo të shqetësohej për shpenzimet.

Më bëri shumë përshtypje ndryshimi i madh midis fëmijërive tona. Kurrë nuk isha merakosur që prindërit e mi mund të mos kishin pará për të më festuar ditëlindjen.

- Por mami im... - vazhdove. - Kisha një kaleidoskop që e adhuroja. E shikoja për orë të tëra, duke rrotulluar e rrotulluar diskun në fund të tij, duke vëzhguar format si zhvendoseshin dhe ndryshonin, duke u fokusuar në të dhe jo në faktin që mami ishte aq e trishtuar, që unë isha aq i trishtuar ngaqë nuk e bëja dot të lumtur, që isha aq i xhindosur me babin.

Nuk munde të më vështrosh teksa flisje; ishe përqendruar te fjalët që po nxirrje nga goja. E vendosa dorën mbi gjurin tënd dhe e shtrëngova fort. Më dhe një buzëqeshje të shkurtër.

- Po pastaj? - të pyeta.

More frymë thellë.

- Ajo e ktheu gjithë shtëpinë në një kaleidoskop, - u përgjigje. - Ishte... ishte i jashtëzakonshëm. Kishte varur copëza xhami me ngjyra në tavan dhe u kishte drejtuar një ventilator, që ato të rrotulloheshin. Ishte një mrekulli.

U përpoqa ta imagjinoja... një shtëpi të kthyer në kaleidoskop.

- Qëndronim të shtrirë atje, mbi dysheme, dhe ia kishim ngulur sytë xhamit me ngjyra. Ndonëse e konsideroja veten një fëmijë të rritur, meqë sapo kisha mbushur dhjetë vjeç dhe kujdesesha aq mirë për

mamin, fillova të qaja. Ajo më pyeti çfarë kisha. Iu përgjigja se nuk e dija as vetë përse po qaja. Ndoshta ngaqë isha i lumtur. Mami ma ktheu: “Është arti, engjëll”. Mendoj se deri diku kishte të drejtë. Ishte arti, por ishte edhe diçka tjetër... Nuk e di.

- Çfarë nuk di? - të pyeta, teksa rrotulloja gishtin e madh pa vetëdije mbi gjurin tënd.

- Tani vras mendjen nëse ishte një lloj lehtësimi. Nëse po qaja, sepse mami po sillej sërish si mamaja ime. Ajo po kujdesej për mua. Megjithëse jetonte në këtë vend të zymtë e të rrënuar, ishte e zonja të krijonte të bukurën. Vras mendjen nëse arti i saj më bëri të kuptoj që mami do të ishte mirë. Që ne të dy do të ishim mirë.

Tashmë e vendose ti dorën mbi gjurin tim.

- Ajo ishte e fortë, - vëreja. - Ajo të donte.

Buzëqeshe sikur po e ndieje dashurinë e saj mu atje, në atë dhomë. Dhe pastaj vazhdove sërish:

- Qëndronim të shtrirë, duke qarë të dy, dhe në ato çaste nuk mund të mos mendoja për babanë tim. Nëse ai do të ishte me ne, nuk do të kishim përfunduar kështu... Por të jetoje me të... si të thashë, ishte e paparashikueshme. Ishte njësoj si të jetoje në Londër, gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur e dije që në çdo moment mund të plasnin sulmet ajrore ose mund të lëshoheshin bombat, por nuk e kishe idenë se ku dhe kur do të ndodhte kjo. I pëshpërita mami: “Jemi më mirë pa të”, ndërsa ajo m’u përgjigj: “E di”. Isha

vetëm dhjetë vjeç, por u ndjeva si i rritur, kur i thashë ato fjalë.

Më ishin mbushur sytë me lot, kur pushove së foluri. Po të përfytyroja ty, dhjetë vjeç, mbi dysheme, me mamanë tënde, duke menduar për babanë, duke u ndier si një i rritur, duke ndier dashurinë e nënës sate, i rrethuar nga arti që ajo kishte krijuar vetëm për ty.

- Prandaj dua t'i bëj diçka të veçantë për ditëlindje, meqenëse nuk do të jem me të, - më shpjegove. - Diçka kuptimplote. Diçka, me të cilën t'i tregoj sa shumë e dua, sa shumë do ta dua gjithnjë, sado larg të jem. Dhe ideja e këtij mozaiku më shkrepri në mendje sot në mëngjes.

Vështrova sërish fotografitë e vogla dhe përpëlita sytë.

- Mendoj se është e përsosur, - mëmërita.

Apartamenti dukej i mbushur me emocion, nga gjithçka që më tregove, nga fakti që e ndave me mua këtë pjesë të brishtë tënden. U përkula përpara të të jepja një përqafim, por ai u shndërrua në një puthje. Buzët tona u prekën për pak sekonda, e pastaj s'ndaheshin dot...

- Faleminderit që ma tregove këtë histori, - fola butësisht.

Më puthe sërish.

- Faleminderit që je personi, të cilit dëshiroja t'ia tregoja.

Vonë, atë mbrëmje, fillove ta ngjisje kaleidoskopin.
Dukeshe aq i lumtur në atë çast, aq i kënaqur, saqë e
lashë përdhe kompjuterin dhe qetësisht mora aparat
tënd fotografik. Është e vetmja fotografi që të kam
bërë. Nuk e di nëse ende e ke...

11

Ndonëse kur ishim vetëm ndiheshim rehat, ndonëse marrëdhënia jonë ishte shumë intime, m'u desh pak kohë të mësohesha të shkoja me ty nëpër festa. Gjithnjë më dukej sikur pluskoja prapa teje. Më dukej sikur ti kishe atë formulën magjike për të tërhequr vëmendjen e njerëzve: fytyra jote, fjalët e tua, historitë që tregojë. Bota e ne të dyve shndërrohej në botën tënde dhe pastaj zgjerohej në një botë të shumë personave, ku unë nuk isha aq e rëndësishme sa më parë. Kështu, nuk më mbetej gjë tjetër veçse të largohesha pa rënë në sy, për të marrë një pije ose për të gjetur dikë tjetër të bisedoja.

Herë pas here i hidhja sytë në drejtimin tënd dhe shihja tek kënaqeshe me turmën që të admironte. Vije e më gjeje kur ishe i dehur dhe i shteruar, sikur magjia

jote ta kishte marrë gjithë energjinë. Kur ishim vetëm të dy ringarkoje bateritë dhe pastaj dilnim sërish dhe shkriheshim me turmën. Në ato momente ndihesha e veçantë që më kishe zgjedhur mua për të rifituar energjinë tënde.

Shembulli tipik i Geibit në një festë, ishte mbrëmja kur vajtëm në ditëlindjen e Gidionit, në apartamentin e prindërve të tij në *Park Evënju*. Aty kishte një bibliotekë, ku nuk duhej të hynim, të paktën jo me pije nëpër duar. Ishim çoroditur nga koktejet e shumta dhe Gidioni ishte shqetësuar se mos i prishnim botimin e parë të Hemingueit, apo librin me autograf të Nabokovit. Dhe ashtu si po pinin të ftuarit, ndoshta duhej vërtet të merakosej.

Po bisedoja me të dashurën e Gidionit, që punonte si specialiste reklamash. Isha e interesuar të dëgjoja për jetën që dikur kisha ëndërruar të jetoja. Teksa krahasonim metodat e dhënies së mesazhit kryesor, ktheva kokën për të të parë, por ti ishe zhdukur. Mendova se kishe shkuar në banjë apo për të mbushur gotën, por kaluan pesë minuta, dhjetë minuta, njëzet minuta dhe ti nuk po ktheheshe.

- Do të më falësh, - iu drejtova asaj, ashtu e hutuar, duke mos mundur ta vazhdoja më tej bisedën. - Më duket se më ka humbur i dashuri.

Ajo qeshi.

- Ndoshta kjo të ndodh shpesh.

Nuk m'u duk aspak për të qeshur.

- Përse mendon kështu? - e pyeta.

Mblodhi supet si për të kërkuar të falur, pasi e kuptoi që kishte thënë gjënë e gabuar.

- Oh, ai është simpatik dhe njerëzve u pëlqen të bisedojnë me të.

- Nuk mund të flas për të tjerët, por mua sigurisht që më pëlqen, - ia ktheva.

Megjithatë, ajo kishte të drejtë. Të gjithë donin të bisedonin me ty. Ata e ndienin që i dëgjoje dhe tregoje interes për ta. Gjithnjë kam menduar se kjo ishte një nga arsyet përse njerëzit, që nuk lejonin askënd tjetër t'u bënte fotografi, ty nuk të kundërshtonin. Ti i bëje të ndiheshin të vlerësuar. Ti më bëje mua të ndihesha e vlerësuar.

U enda nëpër apartament, por nuk të gjeta askund, derisa dëgjoja zërin tënd që vinte nga biblioteka "e ndaluar". Futa kokën brenda dhe të pashë duke folur me një vajzë që nuk e njihja. Kishte flokë të kuq dhe kaçurrelë. Ata dukeshin si një krifë luani rreth fytyrës së saj delikate, që e kishte sa të një maceje. Ndjeva një pështjellim në stomak, kur të pashë të mbështetur te rafti i librave, i hutuar nga çfarë drejtin po të tregonte ajo.

- Ja ku na qenke!

Kur ngrite sytë, nuk vura re asnjë ndjenjë faji në fytyrën tënde. Vetëm një buzëqeshje, sikur po më prisje t'ju bashkohesha.

- Unë? - u çudite. - Ja ku na qenke ti! Rejçëlli po më tregonte për restorantet ku punon si mikpritëse e klientëve. Ajo mund të na sigurojë një zbritje të mirë në çmimet e restorantit.

I hodha një sy Rejçëllit, e cila natyrisht ishte më pak e lumtur se ti, kur më pa. Ishte magjepsur pas teje.

- Jeni shumë e sjellshme, - iu drejtova asaj.

Rejçëlli u shtrëngua të më jepte një buzëqeshje.

- Gëzohem që u takuam, Geib, - mërmëriti. Pastaj ngriti gotën e saj të zbrazur. - Po shkoj te bari ta mbush sërish. Tashmë e ke numrin tim... për rezervimet.

- Faleminderit edhe njëherë, - ia ktheve dhe buzëqeshja jote tashmë po ndriçonte rrugën e saj dhe jo timen. Ajo doli nga dhoma.

Në të vërtetë, nuk dija ç'të të thosha. Nuk të kisha kapur duke bërë ndonjë gjë, përveçse të flisje me dikë për një ofertë çmimesh në restorante. Po pse ishe në bibliotekë me të? Pse nuk erdhe të më gjeje mua?

- Çfarë po bëje këtu? - të pyeta, pa e ngritur zërin.

Ece nëpër dhomë dhe mbylle derën, duke zbardhur dhëmbët.

- Po kërkoja një vend ku mund të bënim këtë, - u përgjigje. Pastaj më kape nga kyçet e duarve dhe i ngrite ata sipër kokës sime, teksa më mbështete në raftin e librave dhe më puthe fort. - Do të bëj dashuri me ty në këtë bibliotekë, - pëshpërite, - edhe pse festa vazhdon aty jashtë. Dhe nuk do ta kyç derën.

- Por...

Më puthe sërish dhe unë nuk protestova më. Nuk më bëhej më vonë që të gjeta në bibliotekë me Rejçëllin. Tashmë isha përqendruar te gishtat e tu, që tërhiqnin getat e mia, teksa zbërtheje zinxhirin e pantallonave.

Tani nuk do ta duroja dot këtë dhe nuk duhet ta kisha duruar as atëherë, kur ti më zbutte me një puthje dhe i fshive shqetësimet e mia me një orgazëm. Duhet të të kisha detyruar të më jepje shpjegime. Duhet të më kishe dhënë një përgjigje, përse po flirtoje me dikë tjetër, përse nuk erdhe të më gjeje. Por ti ishe si një drogë për mua. Kur isha nën efektin tënd asgjë tjetër nuk kishte rëndësi.

- Shht! - pëshpërite, teksa më ngrite fundin. Nuk e kuptova, në të vërtetë, çfarë zhurme po bëja.

E kafshova buzën aq fort, për të mos bërtitur kur e arrita, sa që kur të putha më pas, ndjeva shijen e gjakut në gojët tona.

Të doja shumë dhe nuk e vija në dyshim dashurinë tënde për mua, por nuk e hoqa dot kurrë nga mendja Stefaninë. Mendoj se thellë brenda vetes, isha e shqetësuar se kjo mund të ndodhte sërish, se ti do të më lije për dikë si ajo, apo si Rejçëlli, apo si për një milion femra të tjera që i ndeshje në metro, në kafenenë “Starbucks” ose në marketin e ushqimeve. Lidhja jonë kishte shumë luhatje. Zakonisht ishim në një nivel, ishim të barabartë. Por nganjëherë, e gjeja veten të fundosur, duke u përpjekur të dilja sërish në

sipërfaqe, e frikësuar se ti mund të largoheshe me dikë tjetër dhe unë nuk do të kisha më mundësi ta gjeja ekuilibrin. Por edhe sikur të të kisha thënë diçka në atë bibliotekë, nuk mendoj se do të kishte ndryshuar ndonjë gjë.

Sepse ajo për të cilën duhet të shqetësohesha nuk ishte një femër tjetër...

Megjithatë, këto dyshime nuk më shfaqeshin shpesh... Kishim aq shumë gjëra të tjera që përshtateshin në mënyrë të përkryer. Të dy ishim të interesuar për pasionet e njëri-tjetrit, për karrierat që ëndërronim të kishim një ditë. Ti pe çdo episod të shfaqjes televizive “Duhet një galaktikë”, me të cilën po punoja atëherë, dhe më dhe mendimet e tua që si alienë të ndryshëm krijonin situata sociale për fëmijë. Dukeshe aq i dhënë pas saj, sa që nisa të të kërkoj opinionin tënd, para se shfaqja t’i kalonte produksionit.

Atëherë nuk kisha ndonjë lloj ndikimi të vërtetë. Ende jo. Por më duhej të rishikoja skenarët dhe ilustrimet grafike, si dhe t’i jepja përshtypjet e mia shefit. Ndoshta e kisha marrë këtë përgjegjësi më

seriozisht sesa ishte e nevojshme. Kur i sillja skenarët në shtëpi, ti i interpretoje ata me mua. Gjithnjë më kërkoje të luaje Galakton, djaloshin e vogël me ngjyrë të gjelbër, i cili i ngjasonte një breshke. Ndërsa e preferuara ime ishte Elektra, ajo me ngjyrë të purpurt të errët dhe me një antenë vezulluese. Në njëfarë mënyre, leximi i këtyre skenarëve, të ndihmoi të më tregoje ëndrrat e tua. Kjo shfaqje synon të ndihmojë fëmijët të shprehin ndjenjat e tyre, por mendoj që mund të shihet edhe nga të rriturit. Më kujtohet episodi me të cilin po punonim, kur ndodhi biseda jonë. Ishte fillim nëntori dhe ne kishim bërë pothuajse një të tretën e rrugës drejt sezonit më të ri.

Galakto ulet në oborrin përpara shtëpisë, me kokën në duart e tij.

Elektra: Ç'të ka ndodhur Galakto? *Dukesh i trishtuar.*

Galakto: *Babai im do që të luaj në lojën e yjeve, por unë e urrej atë.*

Elektra: *E di ai këtë?*

Galakto: *Kam frikë t'ia them. Më duket sikur nuk do të dojë të jetë më babai im, nëse nuk e pëlqej lojën e yjeve aq shumë sa ai.*

Elektra: *Babi im e pëlqen lojën e yjeve, ndërsa unë jo, kështu që bëjmë gjëra të tjera së bashku. Ndoshta,*

mund të bësh një listë të gjërave që ju pëlqejnë të dyve.

Galakto: *A thua do të funksionojë? Dhe nuk do të jem më i detyruar të luaj lojën e yjeve?*

Elektra: *Mendoj që ia vlen ta provosh.*

Galakto: *Edhe unë.*

- Mendon që Elektra duhet ta pëlqejë lojën e yjeve dhe jo i ati? - të pyeta, kur përfunduam së lexuari. - Mos duhet ta ndërrojmë paksa stereotipin e gjinisë. Ndoshta do ta sugjeroj këtë nesër.

- Më duket një ide e shkëlqyer, - vërejte duke më vështruar pak më gjatë se zakonisht. Në atë çast, pata ndjesinë që ti pëlqeje jo vetëm idenë time, por gjithçka që unë isha.

Bëra disa shënime te skenari, pastaj e rilexova skenën në heshtje.

- Mendon që Elektra duhet të përmendë disa gjëra që ajo dhe babai i saj preferojnë t'i bëjnë së bashku? A do ta forconte kjo dialogun?

Kësaj here, nuk iu përgjigje pyetjeve të mia, kështu që u ktheva nga ti. Ishe përqendruar në gugatjen e një pëllumbi në shkallët e emergjencës.

- Kam frikë se do të bëhem si ai, - mërmërite.

E lëshova nga dora skenarin.

- Si kush do të bëhesh? - Në mënyrë absurde mendimi im i parë ishte pëllumbi.

Fërkove me dorë mjekrën e parruar.

- Si babai im. Kam gjithë këto ëndrra dhe nuk do t'i realizoj kurrë. Dhe kjo do të më bëjë të ndihem i zemëruar, i tronditur, i dërrmuar dhe do t'i lëndoj të gjithë përreth meje.

- Çfarë ëndrrash ke ti? - të pyeta. - Ëndrra të reja?

- E di ti kush është Stiv Mekëri?

Tunda kokën. Rrëmbeve laptopin tim nga dyshemeja, nise të kërkoje diçka në *google* dhe pastaj e ktheve ekranin nga unë. Pashë një kopertinë të revistës “National Geographic”, ku dallova një vajzë. Kishte vënë një shami në kokë dhe kishte sy ngjyrëjeshilë magjepsës. Ndërsa vështrimi i saj ishte i frikësuar.

- Kjo, - vërejte, - është një nga fotografitë e tij. Po shikonim punën e tij sot, në kursin e fotografisë, dhe unë e ndjeva... Në zemrën time, në shpirtin tim, kudo qofshin pasionet e mia më të thella. Kjo është ajo që dua të bëj. Kjo është ajo që duhet të bëj.

Dallova një zjarr në sytë e tu, që nuk e kisha vënë re më parë.

- Kuptova se, nëse dua të bëj diçka të rëndësishme, diçka vërtet të rëndësishme, ashtu siç po përpiqesh të bësh ti me këtë shfaqje, do të më duhet të iki nga Nju-Jorku. Unë dhe aparati im fotografik mund të japim më shumë diku tjetër.

- Të ikësh? - Nga gjithçka që the, kjo ishte fjala e vetme që ngeci në trurin tim dhe fekste atje si drita e neonit në dhomën e urgjencës. - Çfarë po thua? Po ne të dy?

Për një çast, more një pamje të përhumbur në fytyrë, duke më lënë të kuptoja që përgjigjja ime nuk ishte ajo që prisje. Por, çfarë prisje ti në të vërtetë?

- Unë... nuk mendova për ne të dy... Kjo është ëndrra ime, Lusi, - mëmërite me një zë lutës. - Kam kuptuar cila është ëndrra ime. Nuk mund të jesh e lumtur për mua?

- Si mund të jem e lumtur për një ëndërr tënden, ku unë nuk jam pjesë e saj? - të pyeta.

- Nuk është e vërtetë që nuk je pjesë e saj, - u përgjigje.

M'u kujtua diçka që më kishe thënë pak muaj më parë në park, për prindërit e tu. U përpoqa ta fik atë dritën e neonit në trurin tim dhe të mos mendoja aspak çfarë do t'i shkaktonte universit tim fjala "iki". U përpoqa të shpërfillja pyetjet që i kishe lënë pa përgjigje.

- Ke kuptuar ëndrrën tënde, - përsërita. - Por ëndrra jote nuk është e mundur.

Dallova lotët të grumbulloheshin në qerpikët e tu.

- Dua që të gjithë këtu të kuptojnë, se njerëzit kudo kanë të njëjtat ëndrra, që nuk jemi aq të ndryshëm. Nëse mund ta bëj këtë, nëse mund të krijoj një lidhje...

- Tunde kokën; nuk munde t'i gjeje dot fjalët. - Por duhet të bëj më tepër fotografi, të bëj më tepër kurse; dua të jem më i miri para se të iki.

Pra kishte kohë. Kishim kohë. Ndoshta lidhja jonë do të ishte si ajo që kishe me mamanë tënde. Pasi të

ikje, do të më doje nga larg dhe pastaj do të ktheheshe, kur të përfundoje misionin tënd. Nuk dukej dhe aq e tmerrshme. Mund të funksiononte.

Rrëmbeva dorën tënde.

- Do të jesh më i miri, - mëmërita. - Nëse kjo është ajo që do, do të jesh.

Pastaj u përqaftova të shtrirë në divan, duke thithur frymën e njëri-tjetrit, secili i përhumbar në mendimet e veta.

- Mund të të tregoj diçka? - të pyeta.

Ndjeva se pohove me kokë.

- Druaj se do të bëhem si mamaja ime një ditë.

E ktheve fytyrën nga unë.

- Po ti e adhuron mamanë tënde.

Kishe të drejtë. E adhuroja. Vazhdoj ta adhuroj.

- E dije që ajo dhe babai im u takuan në Fakultetin e Drejtësisë? - të pyeta. - Ta kam përmendur ndonjëherë këtë?

Tunde kokën.

- Juriste është?

- Ishte, - u përgjigja, teksa e futa kokën nën mjekrën tënde. - Punonte për prokurorin e distriktit të *Manhatanit*, para se të lindnim unë dhe Xheisoni. Kur lindi Xheisoni e la punën. Dhe gjatë gjithë pjesës tjetër të jetës së saj, ajo njihej si gruaja e Donit ose mamaja e Xheisonit dhe e Lusit. Kjo i ndodh shumë grave. Por nuk dua të më ndodhë edhe mua.

Më vështrove drejt e në sy.

- Nuk ka pse të të ndodhë ty, Lusi. Ti je e dhënë pas punës, e di çfarë kërkon, punon më shumë se kushdo tjetër. - Pastaj më puthe.

Edhe unë të putha, por brenda vetes, po mendoja se edhe mamaja ime mund t'i kishte të gjitha këto cilësi, por kjo nuk ndikoi aspak. Ajo e humbi karrierën, gjithsesi. Pyesja veten nëse e kishte dashur vetë këtë gjë, apo jo...